

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Datë: 18.06.2018

Në mbështetje të nenit 53, paragrafit 3, dhe nenit 80B të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-222, Ligjin Nr. 04/L-116, Paragrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02./2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dhe Vendimit Nr. 05/89 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e datës 25.05.2016, nenit 8 të Rregullores mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe Ftesës Publike për mbështetje financiare të projekteve/programeve të OJQ-ve Edukim Jo-Formal dhe Informal, bazuar në Vendimin Nr. 1826/2018 për formimin e Komisionit për vlerësimin e projekteve të paraqitura nga OJQ-të, Komisioni Vlerësues nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Në përputhje me detyrat dhe afatet e Komisionit të përcaktuar me vendimin e lartpërmendur dhe duke u bazuar në Thirrjen Publike të datës 14.05.2018, Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjithë dokumentacionin përkatës, të dërguar nga OJQ-të, ku sipas kriterëve komisioni vlerësues ka shpallur fitues për subvencionim këto OJQ:
 1. OJQ "Debate Center"
 2. OJQ "UPISC 2018"
 3. OJQ "D4D"
 4. OJQ "Qendra Edukative e Fmijeve me nevoja te veqanta"
 5. OJQ "ALETRO"
 6. OJQ "YOUTH INNOVATION"
 7. OJQ "ROYAL"
 8. OJQ "ASK KOSOVA"
 9. OJQ "Dukria e Dryshimit te Rinjëve"
 10. OJQ "GAUSI"

11. OJQ "YMDI"
12. OJQ "Alternativa e se Ardhmes"
13. OJQ "CEDF"
14. OJQ "AFSD"
15. OJQ " Qendra per Zhvillim Ekonomik dhe Social"
16. OJQ " Activ +"
17. OJQ "Shoqata Vullnet per Jete"
18. OJQ "ARTHA"
19. OJQ " RROZHRK"
20. OJQ "Qendra per Avancimin e Shoqerise"
21. OJQ " QPDI"
22. OJQ " Ecologia"

ARSYETIMI

Komisioni për Vlerësim brenda afateve të përcaktuar ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni të dorëzuar nga OJQ-t. Në fazën e parë në bazë të kriterëve formale administrative nga 52 (pesedhjetë e dy), kriteret i kanë plotësuar 40 (dyzet) OJQ.

Fazës së dytë të vlerësimit i janë nënshtruar 40 (dyzet) OJQ sipas kriterëve të thirrjes publike për Edukim Jo-Formal dhe Informal, ku komisioni ka vlerësuar secilin aplikacion në mënyrë individuale e të pavarur dhe ka vlerësuar se 21 (njetzenje) OJQ të listuar më lartë plotësojnë kriteret e përcaktuara në thirrjen publike dhe kualifikohen për të përfituar mbështetje financiare nga MKRS-ja.

Komisioni për vlerësim ka vlerësuar se 12 (dymbëdhjetë) aplikacione nuk kanë plotësuar kriteret e thirrjes publike dhe si rrjedhojë nuk kanë marrë pikët e nevojshme për tu kualifikuar për mbështetje financiare.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ fituese duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.


Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda 7 ditësh, aplikimi do të refuzohet dhe nuk do të merret në konsideratë për nënshkrim të kontratës.

Udhëzim Juridik: Kundër këtij vendimi lejohet ankesë në afat prej 5 ditësh nga data e publikimit të këtij vendimi, nëpërmjet arkivës së MKRS-s.

Kryesuesi i komisionit:
Flora Salihu - Kryesues




Anëtarët e komisionit:
Burim Mexhuani - anëtare



Shqipe Rrahmani - anëtare



Fehmi Ramadani - (ekspert i jashtëm, anëtar)



Denis Gashi - (anëtar nga shoqëria civile/OJQ)